



safejournalists.net

Treguesi i Nivelit të Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor

Raport përshkrues Shqipëria 2021

PËRMBAJTJA

MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

7

PARANDALIMI I DUHUR

19

PROCES I RREGULLT

29

SIGURIA AKTUALE

35

Hyrje

Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve të Ballkanit Perëndimor (WB-JSI) është një mjet i bazuar në hulumtim i krijuar për të matur dhe monitoruar ndryshimet në mjediset përkatëse sociale dhe politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në sigurinë e gazetarëve dhe aktorët e medias gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. WB-JSI mbështetet kryesisht në provat kërkimore të mbledhura dhe të analizuar nga partnerët e Platformës [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) në përputhje me një procedurë rigoroze hulumtimi. Të dhënat e mbledhura mbi dimensione të ndryshme të konceptit kompleks të 'sigurisë së gazetarëve' janë kuantifikuar dhe agreguar në një tregues të përbërë – Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve, për të matur ndryshimet me kalimin e kohës në shtatë vendet e Ballkanit Perëndimor. Bazuar në provat kërkimore, nëntë anëtarë të Panelit Këshillimor në secilin vend¹ vlerësojnë situatën dhe caktojnë pikë për secilin prej 19 treguesve brenda dimensioneve të mëposhtme:

- (1) **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave mbrojtëse ligjore të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve;
- (2) **Parandalimi i duhur** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve;
- (3) **Procesi i rregullt ligjor** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve;
- (4) **Siguria aktuale** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

WB-JSI u zhvillua bashkërisht nga studiuesit e Institutit RESIS² me bazë në Shkup dhe partnerët e Platformës Safejournalists.net: Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Serbisë, Shoqata e Gazetarëve të Bosnje dhe Hercegovinës,


¹ Në Shqipëri, Paneli Këshillimor u përbë nga: Gjergj Erebara, Emiljano Kaziaj, Kristina Voko, Orkidea Xhaferaj, Alice Taylor, Elira Çanga, Erlis Çela, Klodiana Kapo dhe Koloreto Çukali.
² Studiuesit e Institutit RESIS (www.resis.mk), Snezhana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Toševa kanë zhvilluar kornizën konceptuale për Indeksin dhe modelin e agregimit, peshimit dhe llogaritjes së tij.

Sindikata e Mediave të Malit të Zi, Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Shoqata e Gazetarëve Kroatë dhe kërkuese e pavarur në Shqipëri.³ Si i tillë, Indeksi është rezultat i një përpjekjeje të përbashkët të Platformës Safejournalists.net dhe mbulon të gjitha çështjet specifike që partnerët lokalë i identifikuan si të rëndësishme për kontekstin e vendit të tyre.

Ky raport i referohet situatës në Shqipëri në vitin 2020, i cili u caktua si viti i parë (pilot) për zhvillimin e kuadrit konceptual dhe metodologjisë për pikëzimin, agregimin dhe llogaritjen e Indeksit. Në vitet në vijim, përmirësimi apo përkeqësimi i situatës në të gjitha vendet do të matet duke marrë në konsideratë vlerësimin për vitin 2020 si vit referencë. Më shumë detaje rreth kornizës teorike dhe procedurës së ndërtimit dhe llogaritjes së WB-JSI dhe të gjitha raportet e vendit mund të gjenden në: <https://safejournalists.net/safety-index/>.

— SUMMARY

Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve
3.38



I. MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

- Në Shqipëri, shpifja është ende një kundërvajtje penale dhe ka pasur përpjekje të kohëve të fundit nga zyrtarët qeveritarë për të rritur sanksionet. Në vitin 2020, u bë një përpjekje për të futur ndryshime në Kodin Penal në lidhje me shpifjen që nwnkuptonin ndryshime deri nw penalizimin e mundshëm të përmbajtjes në internet. Në Shqipëri ka të dhëna të kufizuara në lidhje me dënimet e vendosura ndaj gazetarëve për shpifje dhe përdorimin e precedentëve nga vitet e kaluara. Gazetaria hulumtuese dhe kritike janë veçanërisht më shpesh objekt i padive

³ Blerjana Bino, kërkuese e pavarur e platformës Safejournalists.net në Shqipëri.

për shpifje të nisura nga politikanët dhe përfaqësuesit e bizneseve të mëdha, të cilat mund të prodhojnë një efekt rrëqethës në mediat kritike dhe investigative.

- Mbrojtja e burimeve konfidenciale të informacionit është e garantuar me ligj. Megjithatë, gjyqtarët zakonisht priren të kërkojnë burimet në padi me anë të një interpretimi të lirshëm të asaj që përbën interes publik. Ka pasur raste kur autoritetet (gjyqësore) u kanë kërkuar gazetarëve të zbulojnë burimet e tyre edhe pse si pjesë e hetimeve zyrtare dhe në përputhje me kuadrin ligjor. Në vitin 2020, nuk u regjistruan raste sanksionesh ndaj gazetarëve që refuzuan të zbulojnë identitetin e burimit.
- Përdorimi arbitrar i legjislacionit tjetër si gjendja e jashtëzakonshme dhe kufizimet kundër COVID-19 ishin të dukshme gjatë vitit 2020. SLAPP po rritet në peizazhin mediatik shqiptar si një mekanizëm për të censuruar, frikësuar ose heshtur mediat e pavarura. Në vitin 2020, ka pasur paralajmërime të rëndësishme në lidhje me sigurinë e gazetarëve që raportojnë gjatë protestave. Qasja në informacionin në kohë, cilësor dhe të besueshëm është sfiduese për shkak të mungesës së përgjithshme të transparencës dhe kulturës së llogaridhënies në institucionet publike. Situata aktuale me qasjen në informacionin publik e bën të vështirë për gazetarët të kryejnë raportime investigative dhe të bëjnë shkrime kritike.
- Gazetarët ndonjëherë janë nën presion, gjë që i pengon ata të realizojnë plotësisht profesionin e tyre. Për shkak të kufizimeve të COVID-19, por jo vetëm, në disa raste gazetarët nuk kanë qenë në gjendje ose nuk janë lejuar të raportojnë ngjarje qeveritare, seanca gjyqësore dhe spitale. Edhe pse gazetarët janë të lirë të organizohen në shoqata profesionale, akoma shoqata të tilla përballen me shumë dobësi në aspektin e burimeve, kapaciteteve, rrjetëzimit dhe aftësisë së përgjithshme për të advokuar qeverinë për ndryshimet drejt një mjedisi mediatik mundësues.
- Të drejtat e punës për gazetarët nuk respektohen plotësisht, veçanërisht në mediat private, mediat lokale, mediat online. Gjithashtu, gazetarët e rinj dhe gratë gazetare përballen me më shumë sfida. Mungesa e kontratave të punës, politikat e papërshtatshme të sigurisë sociale dhe të mirëqenies mbeten çështje shqetësuese, si dhe kushtet e përgjithshme të punës së gazetarëve, të cilat u përkeqësuan gjatë pandemisë COVID19. Asnjë marrëveshje kolektive nuk nënshkruhet për mbrojtjen e të drejtave të punës së gazetarëve në mediat private. Nuk ka sindikata të gazetarëve në mediat private në Shqipëri. Jo të gjithë gazetarët kanë qasje në ndihmën juridike falas të ofruar nga media që ata janë të punësuar.

II. PARANDALIMI I DUHUR

- Institucionet shtetërore të Shqipërisë nuk kanë krijuar ende mekanizma efektivë të veçantë për gazetarët dhe stafin e medias për tu siguruar atyre amasa mbrojtëse kur ata kërcënohen. Shërbim ligjor i specializuar për gazetarët ende nuk ka. Shumica e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2020 i referohen arrestimeve të paligjshme të policisë ose ndalimit të gazetarëve gjatë mbulimit të protestave ose raportimit nga terreni. Masat pasuese, të tilla si hetimet dhe sjellja e autorëve para drejtësisë në rast të sulmit ndaj gazetarëve, janë të ngadalta dhe joefektive. Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe offline.
- Mekanizmat e mbrojtjes dhe sigurisë së viktimave të parashikuara në ligj nuk janë posaçërisht për gazetarët dhe viktimat nuk mund të përfitojnë mbrojtje të mjaftueshme ose alternative për zhvendosje brenda në vend, Nuk ka të dhëna në dispozicion se sa gazetarë kanë përfituar nga ky mekanizëm mbrojtjeje dhe sigurie ose nëse e kanë përdorur këtë mekanizëm në vitin 2020. Disa organizata joqeveritare u japin këshilla dhe mbështetje ligjore gazetarëve për të marrë mbrojtje dhe siguri nga mekanizmat ligjorë në vend.
- Shqipëria ka ratifikuar dhe raporton rregullisht në KiE për Konventën e Stambollit, por ende nuk e ka zbatuar atë në mënyrë efektive. Mekanizmat ekzistues për të mbështetur viktimat e dhunës me bazë gjinore janë ende të dobëta dhe jo të pajisura mjaftueshëm për të ofruar këshilla dhe ndihmë për gazetaret femra. These mechanisms are not specific to women journalists and the threats they face in their work.
- Praktika e dënimit të qartë dhe pa ekuivok i sulmeve ndaj gazetarëve nuk është krijuar ende. Përkundrazi, vetë zyrtarët e qeverisë i sulmojnë verbalisht gazetarët. Edhe në rastet kur ka një dënim publik, ai bëhet në kontekstin e konfrontimeve politike.
- Oficerët e policisë nuk treguan ndjeshmëri në veprimet e tyre gjatë vitit 2020 për gazetarët, disa raste u raportuan për ndalime të pabazuara të gazetarëve, veçanërisht gjatë mbulimit të protestave ose ngjarjeve të drejtpërdrejta. Autoritetet policore kanë njohuri bazë se si të sillen me gazetarët dhe profesionistët e mediave, por nuk ka protokolle apo udhëzime për mbrojtjen e gazetarëve në praktikën e tyre të përditshme të punës. Ekzistojnë gjithashtu burime dhe kapacitete të kufizuara për të trajtuar një çështje të tillë të ndjeshme.

III. PROCES I RREGULLT

- Agjencitë e zbatimit të ligjit janë të pajisura në mënyrë të moderuar me njohuritë dhe burimet për të hetuar

sulmet dhe dhunën kundër gazetarëve. Mungojnë protokollet specifike të hetimeve për të siguruar zbulimin dhe ndjekjen efikase të agresionit dhe dhunës ndaj gazetarëve. Sfidat e përgjithshme që lidhen me reformën e vazhdueshme të drejtësisë dhe procesin e vetingut ndikojnë në kapacitetet dhe burimet e prokurorive dhe gjykatave për t'u marrë me rastet e gazetarëve.


- Sulmet fizike kundër gazetarëve gjatë viteve të fundit nuk janë hetuar siç duhet. Disa raste mbeten të pazgjidhura dhe ka transparencë të kufizuar në procesin hetimor edhe për shkak të fshehtësisë së hetimit. Zakonisht këto procese janë të gjata, të ngadalta dhe me informacion të kufizuar publik.
- Autoritetet shtetërore nuk kanë njohuri, kompetenca, burime dhe procedura për mbrojtjen e gazetarëve nga ngacmimet online. Nuk janë marrë masa specifike për të mbrojtur gazetarët nga sulmet online. Ngacmimi online është veçanërisht shqetësues për gazetaret femra.
- Nuk ka tregues që të evidentojë se kryhen hetimet për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Autoritetet nuk japin të dhëna të përditësuara për rastet kryesore të sulmeve fizike ndaj gazetarëve.
- Asnjë nga autoritetet kompetente shtetërore dhe gjyqësore nuk kanë krijuar sisteme cilësore dhe specifike të mbledhjes së statistikave mbi sulmet kundër gazetarëve dhe mbi pandëshkueshmërinë. Institutions Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla.

IV. SIGURIA AKTUALE

- Disa raste janë identifikuar si kërcënuese për punën e pavarur të gazetarëve në Shqipëri nëpërmjet shtimit të padive kundër gazetarëve, veçanërisht gazetarëve investigativ. Këto padi zakonisht ngrihen nga zyrtarë qeveritarë, politikanë dhe korporata të mëdha biznesi.
- Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve ekzistojnë në mënyrë të nënkuptuar dhe të qartë dhe disa raste u raportuan në vitin 2020 nga Rrjeti i Sigurt i Gazetarëve dhe platforma të tjera ndërkombëtare për lirinë e medias. Sidoqoftë, raste të tilla nuk janë sistemike.
- Sulmet aktuale kundër gazetarëve janë regjistruar në vitin 2020 siç janë dëmtimet fizike aktuale, ndalimi arbitrar, konfiskimi i pajisjeve dhe ndërprerja e raportimit veçanërisht gjatë protestave në maj dhe dhjetor 2020.
- Në vitin 2020, ka pasur vetëm disa raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj mediave dhe asnjë rast sulmi ndaj shoqatës së gazetarëve.

Mjedisi ligjor dhe organizativ

3.49



Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi e tyre nuk prodhojnë efekte frenuese për gazetarët dhe mediat

Pikët (2.91) – Në Shqipëri, shpifja është ende një kundërvajtje penale dhe ka pasur përpjekje të kohëve të fundit nga zyrtarët qeveritarë për të rritur sanksionet. Në vitin 2020, u bë një përpjekje për të futur ndryshime në Kodin Penal në lidhje me shpifjen që nwnkuptonin ndryshime deri nw penalizimin e mundshëm të përmbajtjes në internet. Në Shqipëri ka të dhëna të kufizuara në lidhje me dënimet e vendosura ndaj gazetarëve për shpifje dhe përdorimin e precedentëve nga vitet e kaluara. Gazetaria hulumtuese dhe kritike janë veçanërisht më shpesh objekt i padive për shpifje të nisura nga politikanët dhe përfaqësuesit e bizneseve të mëdha, të cilat mund të prodhojnë një efekt rrëqethës në mediat kritike dhe investigative.

Në Shqipëri, dhe në kundërshtim me praktikën më të mira ndërkombëtare, shpifja konsiderohet si kundërvajtje penale. Në Kodin Penal në fuqi shpifja përkufizohet si "Përhapja e qëllimshme e thëniesve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit." Sipas këtij Kodi, shpifja dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë, por mund të jenë më të larta në rrethana cilësuese. Në vitin 2012, Kodi Penal u rishikua duke hequr dënimin me burg deri në dy vjet për shpifjen. Edhe Kodi Civil ka dispozita për shpifjen. Në vitin 2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë shqyrtoi 13 raste për kundërvajtjen penale të shpifjes dhe 62 padi civil për shpifje në vitet 2018 dhe 2019. Pothuajse gjysma e këtyre proceseve gjyqësore kishin në shënjestër gazetarët dhe mediat. Në dhjetor 2020, qeveria u përpoq të bënte ndryshime në Kodin Penal në lidhje me shpifjen, të cilat nënkuptonin edhe kriminalizimin e memeve satirike dhe postimeve të tjera në internet. Ky propozim kishte të bënte me një rritje jashtëzakonisht të madhe të gjobave për shpifjen dhe riformulimin e kundërvajtjes për ta bërë më të lehtë shpalljen e njerëzve fajtorë. Gjoha u propozua të rritej në 36,000 Euro për shpifjet dhe përgjegjësia për veprën penale do të shkonte përtej gazetarëve duke përfshirë edhe redaktorët dhe drejtorët

— TREGUESI 1.1

e mediave. Këto ndryshime u kundërshtuan fuqishëm nga shoqëria civile dhe shoqatat e mediave, ndaj Qeveria nuk vijoi më tej me propozimin. Sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, në vitin 2020 u konfirmuan dymbëdhjetë padi kundër gazetarëve. Politikanët dhe përfaqësuesit e bizneseve të mëdha zakonisht hapin procese të tilla gjyqësore në përpjekje për të detyruar të heshtin gazetarët investigativë apo mediat kritike. Gazetarët dhe ekspertët e medias argumentojnë se situata aktuale po kontribuon në përkeqësimin e lirisë së medias, duke penguar kështu punën e tyre të pavarur, gazetarinë investigative dhe përmbajtjen e medias kritike.

Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve garantohet me ligj dhe respektohet nga autoritetet

Pikët (4.51) – Mbrojtja e burimeve konfidenciale të informacionit është e garantuar me ligj. Megjithatë, gjyqtarët zakonisht priren të kërkojnë burimet në padi me anë të një interpretimi të lirshëm të asaj që përbën interes publik. Ka pasur raste kur autoritetet (gjyqësore) u kanë kërkuar gazetarëve të zbulojnë burimet e tyre edhe pse si pjesë e hetimeve zyrtare dhe në përputhje me kuadrin ligjor. Në vitin 2020, nuk u regjistruan raste sanksionesh ndaj gazetarëve që refuzuan të zbulojnë identitetin e burimit.

Mbrojtja e burimeve konfidenciale të informacionit është një nga parimet themelore të punonjësve të medias, sipas dispozitave të ligjit për mediat. Veç kësaj, Neni 159 i Kodit të Procedurës Penale i përfshin gazetarët mes profesioneve që nuk janë të detyruar ta zbulojnë burimin e informacionit, duke e konsideruar atë sekret profesional. Megjithatë, me vendim gjykate mund të provohet se burimi i informacionit është provë themelore dhe gazetarëve mund t'u kërkohej zbulimi i tij. Gazetarët kanë detyrimin etik që të mos e zbulojnë burimin e tyre të informacionit. Në Shqipëri, konfidencialiteti i burimit të gazetarëve është sfidë më vete edhe për faktin se Shqipëria është një vend i vogël dhe lidhjet shoqërore dhe familjare janë shumë të forta. Mediat vendore, në veçanti, e kanë të vështirë t'i mbrojnë burimet e informacionit. Ka pasur raste kur autoritetet (gjyqësore) kanë urdhëruar zbulimin e burimeve, por si pjesë e hetimeve zyrtare dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjykata mund t'u kërkojë gazetarëve me anë të një urdhri me shkrim të zbulojnë burimin konfidencial të informacionit nëse është në interes të publikut. Në vitin 2020, nuk u regjistrua asnjë rast sanksionesh ndaj gazetarëve që refuzuan të zbulonin identitetin e burimit. Në 2016, u konfirmua të paktën një rast, ai i gazetarit Artan Hoxha, ndaj të cilit prokuroria nisi një hetim për shkak të refuzimit nga ana e gazetarit për të zbuluar identitetin e burimit të tij. Në raste korrupsioni, legjislacioni ofron mbështetje për sinjalizuesit. Sidoqoftë, funksioni dhe roli i sinjalizuesve është interpretuar shumë ngushtë duke i përcaktuar praktikisht praktikën e sinjalizimit vetëm në dritën e një marrëdhënie punësimi, ku një sinjalizues konsiderohet të jetë ai person i cili është ose ishte i punësuar nga subjekti (privat apo publik) i dyshuar për përfshirje në

— TREGUESI 1.2

praktika korruptive. Për më tepër, kur sinjalizimi bëhet publik, sipas ligjit personi nuk përfiton më nga mbrojtja e dhënë ndaj sinjalizuesve nga ligji në fjalë. Prandaj, çdo atribuim ndaj gazetarëve si përfitues të një mbrojtjeje të tillë do të kërkonte një interpretim të zgjeruar të dispozitave aktuale ligjore.

Ligjet e tjera zbatohen me objektivitet dhe u bëjnë të mundur gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias të punojnë lirshëm dhe të sigurt

Pikët (3.41) – Përdorimi arbitrar i legjislacionit tjetër si gjendja e jashtëzakonshme dhe kufizimet kundër COVID-19 ishin të dukshme gjatë vitit 2020. SLAPP po rritet në peizazhin mediatik shqiptar si një mekanizëm për të censuruar, frikësuar ose heshtur mediat e pavarura. Në vitin 2020, ka pasur paralajmërime të rëndësishme në lidhje me sigurinë e gazetarëve që raportojnë gjatë protestave. Qasja në informacionin në kohë, cilësor dhe të besueshëm është sfiduese për shkak të mungesës së përgjithshme të transparencës dhe kulturës së llogaridhënies në institucionet publike. Situata aktuale me qasjen në informacionin publik e bën të vështirë për gazetarët të kryejnë raportime investigative dhe të bëjnë shkrime kritike.

Për shkak të pandemisë COVID19, Shqipëria kishte shpallur gjendjen e jashtëzakonshme (të katastrofës natyrore) nga marsi deri në qershor 2021 dhe qeveria shqiptare njoftoi Këshillin e Evropës se do të vononte zbatimin e ligjeve për të drejtat e njeriut (shmangie nga detyrimet) sipas neneve 8 dhe 11 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (mars-qershor 2020). Si rezultat, u imponuan shumë kufizime edhe ndaj gazetarëve veçanërisht në lidhje me lirinë e lëvizjes dhe aksesin në informacionin publik. Shpejtësia në të cilën ekzekutivi në Shqipëri zgjeroi fuqinë e tij gjatë gjendjes së jashtëzakonshme mund të sugjerojë që ligjvënësit dhe gjyqësori mund të mos jenë në gjendje të sigurojnë kontrollin dhe ekuilibra të mjaftueshëm për tejkalimin e kompetencave nga ana e ekzekutivit, duke ndikuar kështu edhe në lirinë e medias. Edhe pse nuk mund të merreshin të dhëna të sakta për paditë e ngritura dhe sanksionet kundër gazetarëve bazuar në dispozitat ligjore për përhapjen e dezinformatave, frikës, panikut etj., për këtë raport, gazetarë dhe ekspertë të cilët vënë në dyshim ose kritikojnë masat e marra nga qeveria për të luftuar pandeminë COVID19 argumentojnë se e gjejnë veten të akuzuar për “përhapje paniku në një kohë lufte”. Po ashtu, nga një hetim i BIRN u konstatua se Policia e Shtetit kërkoi ndjekjen penale për shumë qytetarë – shumica e tyre gazetarë

dhe drejtues të medias, me akuzën e përhapjes së panikut pas tërmetit të nëntorit 2019 dhe gjatë pandemisë COVID-19. Kështu, Policia e Shtetit referoi për ndjekje penale 5 gazetarë dhe 3 administratorë të mediave online për artikuj në lidhje me tërmetet e shtatorit dhe nëntorit 2019, të cilat sipas tyre kishin ngjallur panik si rezultat i përhapjes së informacionit të rremë.

Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (që njihen me termin "Paditë SLAPP") po bëhen më të shpeshta në peizazhin mediatik në Shqipëri si mekanizëm për të censuruar, frikësuar apo heshtur median e pavarur, gazetarët investigativë dhe kritikët duke i ngarkuar atyre barrën e kostove të mbrojtjes ligjore deri sa këta të fundit të detyrohen të mos bëjnë më kundërshtime apo kritikë. Vetëm në dhjetor 2020 ka pasur tre padi SLAPP në Shqipëri. Një padi kishte të bënte me partneritetin publik-privat të qeverisë për inceneratorët në Elbasan. Në janar Acromax kërcënoi se do të padiste Alice Taylor dhe Exit.al për një investigim që këta të fundit kishin bërë për punën e kësaj kompanie për Partinë Socialiste, përfshirë këtu heqjen e përmbajtjes nga platformat sociale si Facebook dhe YouTube. Padiat nuk u materializua kurrë. Për shkak të kufizimeve të COVID-19, ndjekja me prani fizike të seancave të Parlamentit në vitin 2020 nuk ishte gjithmonë e mundur. Për më tepër, edhe pse teknologjia bën të mundur mbajtjen e konferencave të shtypi nëpërmjet platformës ZOOM ose platformave të tjera të ngjashme, institucionet shëndetësore pranonin pyetje vetëm me shkrim gjatë gjendjes së jashtëzakonshme së vendit. Problemi në Shqipëri është se numri i ngjarjeve, konferencave për shtyp dhe aktiviteteve të tjera ku gazetarët mund të marrin pjesë dhe të bëjnë pyetje është në rënie, duke pasur parasysh se Qeveria dhe partitë politike përgatisin material të gatshme dhe mediat thjesht i transmetojnë ato. Ka pasur raste kur gazetarëve u është refuzuar e drejta për të raportuar një ngjarje gjatë periudhës së zgjedhjeve apo edhe në raste të tjera. Edhe në konferencat për shtyp dhe ngjarje të tjera të Kryeministrit ose të zyrtarëve të tjerë të qeverisë, ka raste që gazetarëve nuk u lejohet të marrin pjesë në këto takime për të bërë pyetje. Në vitet 2019 dhe 2020, gazetarët janë qëlluar me armë automatike në shtëpitë e tyre, janë kërcënuar me armë zjarri, janë helmuar me gaz në rrugë, kanë marrë kërcënime me vdekje në televizion drejtpërsëdrejti, u janë revokuar lejet e qëndrimit, janë bërë shënjestër e fushatave të shpifjeve dhe janë paditur nga Kryeministri – vetëm sepse ushtronin profesionin e tyre. Që nga qershori i vitit 2020, statistikave të sigurisë dhe pandëshkueshmërisë janë publikuar edhe në Rrjetin e Gazetarëve të Sigurt me një total prej 17 rastesh. Në vitin 2020, në Shqipëri u organizuan dy protesta të fuqishme: një në maj kundër prishjes së Teatrit Kombëtar dhe një në dhjetor për vrasjen e një të riu nga policia. Në të dy rastet u raportuan njoftime për cenimin e sigurisë dhe për sulme ndaj gazetarëve. Për shembull, pas shembjes së Teatrit Kombëtar në 17 maj 2020, redaktori i Politiko.al Alfred Lela u arrestua me dhunë teksa raportonte për protestën. . Më 11 dhjetor, policia ndaloi Xhoi Malësinë, gazetar dhe spiker i lajmeve në RTV Ora News, teksa filmonte protestat. Gazetari

— TREGUESI 1.3

u lirua pas tre orësh, por raportoi abuzime me të drejtat e tij. Më 11 dhjetor, Qamil Xhani, kryeredaktor i së përditshme 'Koha Jonë', u arrestua teksa ishte në krye të detyrës. Pasi kishte mbaruar raportimin, Xhani u bë dëshmitar i dhunës së policisë ndaj protestuesve. Redaktori i Durrës Lajm Shefqet Duka u ndalua nga policia teksa po largohej nga ambientet e medias pranë Sheshit Liria ku po zhvillohej një protestë. Aldo Mustafa, gazetari lokal i Syri.net TV në qytetin e Durrësit ishte në detyrë duke raportuar drejtpërdrejt protestën në vendlindjen e tij kur u sulmua nga një prej policëve dhe nuk u lejua të filmonte dhe raportonte për ndalimin e protestuesve nga policia.

Gazetarët janë të lirë të ndjekin profesionin e tyre dhe të krijojnë, të anëtarësohen dhe të marrin pjesë në shoqatat e tyre

Pikët (3.96) – Gazetarët ndonjëherë janë nën presion, gjë që i pengon ata të realizojnë plotësisht profesionin e tyre. Për shkak të kufizimeve të COVID-19, por jo vetëm, në disa raste gazetarët nuk kanë qenë në gjendje ose nuk janë lejuar të raportojnë ngjarje qeveritare, seanca gjyqësore dhe spitale. Edhe pse gazetarët janë të lirë të organizohen në shoqata profesionale, akoma shoqata të tilla përballen me shumë dobësi në aspektin e burimeve, kapaciteteve, rrjetëzimit dhe aftësisë së përgjithshme për të advokuar qeverinë për ndryshimet drejt një mjedisi mediatik mundësues.

Gazetarët nuk kanë nevojë të jenë të licencuar nga shteti për të punuar. Gjatë vitit të kaluar, nuk ka pasur asnjë përpjekje nga ana e shtetit për të prezantuar licencime të tilla. Për shkak të kufizimeve të pandemisë COVID-19, gazetarët nuk mund të raportojnë nga seancat gjyqësore. Për më tepër, edhe pse teknologjia bën të mundur mbajtjen e konferencave të shtypit nëpërmjet platformës ZOOM ose platformave të tjera të ngjashme, institucionet shëndetësore pranonin pyetje vetëm me shkrim gjatë mbylljes së vendit. Problemi në Shqipëri është se numri i aktiviteteve, konferencave për shtyp dhe ngjarjeve të tjera ku gazetarët mund të marrin pjesë dhe të bëjnë pyetje është në rënie, duke pasur parasysh se Qeveria dhe partitë politike përgatisin material të gatshme dhe mediat thjesht i transmetojnë ato. Ka pasur raste kur gazetarëve u është refuzuar e drejta për të raportuar një ngjarje gjatë periudhës së zgjedhjeve apo edhe në raste të tjera. Edhe në konferencat për shtyp dhe ngjarje të tjera të Kryeministrit ose të zyrtarëve të tjerë të qeverisë, ka raste që gazetarëve nuk u lejohet të marrin pjesë në këto takime për të bërë pyetje. Parlamenti, Këshilli i Ministrave dhe ministritë e linjës kanë procedurë të ngritura për akreditimin e gazetarëve dhe stafit të medias. Praktikë e zakonshme për të gjithë autoritetet publike është kërkesa që gazetarët të mbajnë një dokument që i identifikon lehtësisht. Gazetarët janë të organizuar në shoqata profesionale, por këto shoqata nuk janë të konsoliduara dhe kanë mangësi në burime dhe kompetenca. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ka rreth 1,200 anëtarë dhe ka krijuar degë në 10 qytete të Shqipërisë. Shoqata e Gazetarëve Profesionalistë të Shqipërisë ka rreth 220 anëtarë dhe një bord me 12 gazetarë. Është anëtare

— TREGUESI 1.4

e asociuar i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve. Në Shqipëri nuk ka sindikata të gazetarëve. Në parim, gazetarët janë të lirë të anëtarësohen në shoqata. Në vitin 2020, nuk janë raportuar raste ku gazetarët të jenë penguar për t'u bërë anëtarë të shoqatave. Të dhënat e mbledhura për këtë studim nuk konfirmojnë ekzistencën e organizatave paralele ose të rreme të mediave, puna e të cilave mbështetet nga qeveria ose nga organizata të fuqishme politike në mënyrë që të minojnë pozicionin kritik të shoqatave të mirëfillta të gazetarëve.

Vendi i punës i gazetarëve është i garantuar dhe i mbrojtur në mjedisin e punës

Pikët (2.66) – Të drejtat e punës për gazetarët nuk respektohen plotësisht, veçanërisht në mediat private, mediat lokale, mediat online. Gjithashtu, gazetarët e rinj dhe gratë gazetare përballen me më shumë sfida. Mungesa e kontratave të punës, politikat e papërshtatshme të sigurisë sociale dhe të mirëqenies mbeten çështje shqetësuese, si dhe kushtet e përgjithshme të punës së gazetarëve, të cilat u përkeqësuan gjatë pandemisë COVID19. Asnjë marrëveshje kolektive nuk nënshkruhet për mbrojtjen e të drejtave të punës së gazetarëve në mediat private. Nuk ka sindikata të gazetarëve në mediat private në Shqipëri. Jo të gjithë gazetarët kanë qasje në ndihmën juridike falas të ofruar nga media që ata janë të punësuar.


Mungesa e kontratave të punës mbetet problem, veçanërisht për gazetarët e rinj dhe ata që punojnë për mediat online. Pagesat e sigurimeve janë ende problem shqetësues, veçanërisht mungesa ose leja e kufizuar e lindjes për të dy prindërit. E drejta e punës e gazetarëve në Shqipëri u vështirësua edhe më tej në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19 dhe vështirësive ekonomike të mediave. Rregullsia e pagesave është një problem veçanërisht për gazetatat, mediat online dhe ato lokale. Paga mesatare e gazetarëve është rreth 500-600 Euro në muaj, por që shkon maksimumi edhe 1,800 Euro në muaj dhe minimumi 250 Euro në muaj. Kushtet e punës së gazetarëve janë të vështira dhe lidhen me mosrespektimin e kontratave, që lidhen me aspekte të ndryshme të tilla si mohimi i pushimeve të paguara, abuzimi verbal në vendin e punës dhe diskriminimi për shkak të gjinisë ose bindjeve politike; mungesa e sigurisë gjatë ushtrimit të detyrës; problemet e sigurisë në lidhje me raportimin e krizave dhe fatkeqësive natyrore, si tërmete, përmytje, COVID-19, protestat. Raportohet më shpesh se gazetarët e mediave online se punojnë në të zezë (pa kontrata pune) dhe në kushte anonimati. Kjo gjë u bën të pamundur atyre të mbrojnë të drejtat e autorit dhe të krijojnë një profil personal profesional, për t'u bërë kështu pjesë e barabartë e komunitetit të gazetarëve profesionistë. Shkelja e të drejtës së autorit është problem i madh edhe në mediat audiovizive, ato shkruara dhe ato online. Në mediat private gazetarët nuk janë të organizuar në sindikata. Atyre nuk u ofrohet ndihmë ligjore falas nga punëdhënësi. Nuk ka marrëveshje kolektive të nënshkruar për mbrojtjen e

të drejtave të gazetarëve në mediat private. Në përgjithësi, gazetaret femra raportojnë të njëjtat kushte pune si kolegët e tyre meshkuj, me ndryshimin e vetëm se gratë e gazetarisë raportojnë raste edhe të ngacmimeve seksuale. Kontratat e punës që nënshkruajnë ato nuk kanë lidhje me gjininë e gazetarëve, por me vështirësitë e mëdha të mediave. Gazetarët femra ankohen edhe për mosdhënien e lejes së lindjes, gjë që ndikon në zgjedhjet që bëjnë për jetën e tyre. Sipas një studimi të fundit për të drejtat e punës së gazetarëve në Shqipëri, 80% e grave gazetare thonë se punojnë me kohë të plotë dhe besojnë se paguhen më pak se homologët e tyre meshkuj. Në diskutimet në fokus grupe, gazetarët raportojnë ngacmime seksuale në vendin e punës, kryesisht ndaj grave dhe vajzave duke marrë parasysh që menaxherët, redaktorët dhe pronarët janë përgjithësisht burra me “një qëndrim prej padroni dhe pushtetari ndaj gazetarëve të rinj që përpiqen të bëjnë emër në gazetari.” Nuk ka sindikata të gazetarëve në mediat private. Nuk ka ndihmë juridike falas të siguruar nga media për gazetarët. Nuk ka marrëveshje kolektive të nënshkruar për mbrojtjen e të drejtave të punës së gazetarëve në mediat private.



Parandalimi i duhur

2.97



Gazetarët dhe aktorët e medias kanë akses te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar

Pikët (2.85) – Institucionet shtetërore të Shqipërisë nuk kanë krijuar ende mekanizma efektivë të veçantë për gazetarët dhe stafin e medias për tu siguruar atyre amasa mbrojtëse kur ata kërcënohen. Shërbim ligjor i specializuar për gazetarët ende nuk ka. Shumica e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2020 i referohen arrestimeve të paligjshme të policisë ose ndalimit të gazetarëve gjatë mbulimit të protestave ose raportimit nga terreni. Masat pasuese, të tilla si hetimet dhe sjellja e autorëve para drejtësisë në rast të sulmit ndaj gazetarëve, janë të ngadalta dhe joefektive. Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe offline.

Në Shqipëri, institucionet shtetërore ende nuk i kanë krijuar mekanizmat efektivë që janë specifike për gazetarët dhe stafin e medias për t'u ofruar atyre masa mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar. Ndihma juridike falas u ofrohet kryesisht grupeve në nevojë, ndihmë që nuk është e specializuar për ofrimin e këshillave ligjore për gazetarët. Ndihma juridike është detyrim i qeverisë. Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për rregullimin e këtij procesi. Vetë ndihma juridike administrohet nga gjykatat dhe Dhoma e Avokatëve. Gjithsesi, janë edhe disa organizata joqeveritare që operojnë në këtë fushë, të pavarura nga shërbimi shtetëror. Ministria e Brendshme ka vendosur një numër emergjence që çdo qytetar mund ta përdorë falas për të raportuar drejtpërsëdrejti dhe menjëherë në polici një kërcënim ose një emergjencë. Gazetarët mund ta përdorin këtë linjë telefonike për të raportuar kërcënime serioze për jetën ose për sulme që u bëhen atyre. Nuk ka asnjë linjë telefonike të vendosur nga Ministria e Brendshme ku të raportohen rastet e gjuhës së urrejtjes.

Pjesa më e madhe e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2020 i referohen arrestimeve të paligjshme ose ndalimit të gazetarëve nga policia teksa mbulonin protestat ose bënin raportime nga terreni. Prandaj, gazetarët faktikisht nuk mund ta përdorin këtë mekanizëm. Në raste të tjera të raportuara të sulmeve fizike ndaj tyre, gazetarët e kanë përdorur këtë mekanizëm dhe Policia ka reaguar menjëherë. Megjithatë,

— TREGUESI 2.1

veprimet që janë ndërmarrë më tej, si hetimet dhe sjellja e autorëve para drejtësisë, kanë qenë të ngadalta dhe joefektive.

Në përgjithësi, institucionet përkatëse pranojnë një denoncim nga gazetarët ose media për shkeljen e të drejtave të tyre dhe e trajtojnë atë në përputhje me dispozitat në fuqi. Gjithsesi, institucionet shtetërore nuk janë shumë të përgjegjshme dhe efektive në trajtimin e rasteve ku gazetarët bien pre e kërcënimeve edhe për shkak të mangësive në burime dhe kapacitete. Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe offline.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë akses te mekanizmat specifikë mbrojtjeje/sigurie

Pikët (2.78) – Mekanizmat e mbrojtjes dhe sigurisë së viktimave të parashikuara në ligj nuk janë posaçërisht për gazetarët dhe viktimat nuk mund të përfitojnë mbrojtje të mjaftueshme ose alternative për zhvendosje brenda në vend, Nuk ka të dhëna në dispozicion se sa gazetarë kanë përfituar nga ky mekanizëm mbrojtjeje dhe sigurie ose nëse e kanë përdorur këtë mekanizëm në vitin 2020. Disa organizata joqeveritare u japin këshilla dhe mbështetje ligjore gazetarëve për të marrë mbrojtje dhe siguri nga mekanizmat ligjorë në vend.

Nuk ka asnjë mekanizëm specifik për sigurinë e gazetarëve, përveç programit të mbrojtjes së viktimave për qytetarët, veçanërisht për gratë viktime të dhunës në familje. Ekzistojnë pengesa në urdhrin e mbrojtjes së marrë për viktimat e kërcënimeve ose të dhunës. Legjislacioni u siguron mbrojtje dëshmitarëve ose të ashtuquajturve bashkëpunëtorë të drejtësisë, term që interpretohet shumë ngushtë si (i) dikush që tashmë konsiderohet i pandehur në një procedim penal, (ii) një dëshmitar ose palë e dëmtuar që mund të dëshmojë për rrethanat në lidhje me një procedim penal, dhe (iii) një person i lidhur (qoftë përmes familjes ose lidhjeve të tjera të ngushta) të i) dhe ii). Të tre këto kategori të ndryshme duhet të jenë në një situatë rreziku për shkak të përfshirjes së tyre në procedimin penal (në mbështetje të sistemit të drejtësisë) për të qenë në gjendje të përfitojnë nga programet e mbrojtjes.

Ligji Nr. 9205/2004 përcakton masat e veçanta, mënyrën dhe procedurën e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të veçanta të mbrojtjes. Mbrojtja e viktimave dhe mekanizmat e sigurisë të parashikuar në ligj nuk janë të përshtatur për gazetarët dhe viktimat nuk mund të përfitojnë mbrojtje të

— TREGUESI 2.2

mjaftueshme ose të kenë një alternativë për të ndërruar vendbanim në vend. Ishte e pamundur që për këtë raport të mblidheshin të dhëna për gazetarë që mund të kenë qënë të kualifikuar si dëshmitarë sipas ligjit në fjalë dhe të kenë përfituar nga mundësia e lartpërmendur e mbrojtjes.

Ka organizata joqeveritare që ofrojnë mbështetje dhe ndihmë për gazetarët (Komiteti Shqiptar i Helsinkit ofron ndihmë juridike; Republika ofron ndihmë juridike). Horizontal Facility: Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Evropën Jug-Lindore (JUFREX 2) kanë organizuar trajnime për gazetarët për t'i fuqizuar ata se si të aplikojnë për ndihmë juridike, për mbështetje financiare dhe masa të tjera në dispozicion për mbështetjen e tyre.

Gazetare gra kanë akses te masat ligjore dhe mekanizmat e mbështetjes kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

Pikët (3.49) – Shqipëria ka ratifikuar dhe raporton rregullisht në KiE për Konventën e Stambollit, por ende nuk e ka zbatuar atë në mënyrë efektive. Mekanizmat ekzistues për të mbështetur viktimat e dhunës me bazë gjinore janë ende të dobëta dhe jo të pajisura mjaftueshëm për të ofruar këshilla dhe ndihmë për gazetaret femra. These mechanisms are not specific to women journalists and the threats they face in their work.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën e Stambollit në dhjetor 2011, konventë që u ratifikua në 2013 dhe që hyri në fuqi në gusht 2014. Barazia gjinore nuk është ende e integruar plotësisht dhe gjuha është neutrale në aspektin gjinor. Politikat zakonisht e pranojnë natyrën gjinore të dhunës ndaj grave. Masat e para që Shqipëria miratoi për të luftuar dhunën ndaj grave ishin ato në lidhje me dhunën në familje. Në veçanti, që nga miratimi i Ligjit Nr. 9669/2006 "Për Masat kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", janë hartuar politika për të ofruar një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj dhunës në familje ku përfshihen parandalimi, mbrojtja dhe ndjekja penale. Si për krahasim, format e tjera të dhunës ndaj grave, të tilla si martesë e detyruar, ngacmimi seksual dhe dhuna seksuale, kanë marrë fare pak vëmendje në aspektin legjislativ dhe politik. Dhe ka të dhëna shumë të kufizuara në lidhje me format e tjera të dhunës dhe nuk ka të dhëna sistematike me fokus të veçantë tek gratë gazetare. Ngacmimi njihet edhe nga Ligji Nr. 9970 "Për barazinë gjinore në shoqëri". Në këtë rast është ngacmim që lidhet në mënyrë rigoroze me gjininë, edhe në kushtet/marrëdhëniet e punës. Në Shqipëri, mekanizmat lokalë të referimit veprojnë në nivelin bashkie dhe në të bëjnë pjesë një grup i gjerë përfaqësuesish nga autoritetet përkatëse dhe shoqëria civile për t'i dhënë një përgjigje të fortë të unifikuar dhunës në familje. Këto mekanizma duhet të konsolidohen dhe bëhen më efektive. Mekanizma të tillë janë krijuar dhe pajisur kryesisht vetëm për të mbështetur viktimat e dhunës në familje, por nuk janë trajnuar dhe të përgatitur plotësisht për të ofruar ndihmë dhe këshilla profesionale për gazetaret femra në lidhje me sfidat e tyre specifike.

Ligji Nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të saj parashikojnë që qytetarët në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale, grupet e marginalizuara, viktimat e dhunës në familje dhe personat me aftësi të kufizuara përfitojnë nga ndihma juridike falas. Ministria e Drejtësisë ka ngritur Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike. Kjo drejtori ka si mision të sigurojë akses të barabartë të sistemi i drejtësisë për të gjithë individët përmes ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Është botuar edhe një manual online ku përdoruesit orientohen se si të marrin ndihmë juridike falas. Qeveria ka nxjerrë VKM të ndryshme në zbatim të këtij ligji. Në përgjithësi, gazetaret femra nuk u drejtohen institucioneve për ngacmime ose kërcënime, veçanërisht kur bëhet fjalë për ngacmime seksuale në vendin e punës. Po ashtu, gazetaret femra nuk marrin ndihmë për diskriminimin me bazë gjinore. Normalisht sipas Kodit të Procedurës Penale viktimat ka të drejtë të marrë informacion për ecurinë e çështjes së tij/saj dhe të informohet për të drejtat e tij/saj, prandaj kjo është një e drejtë ligjore që sistemi i drejtësisë si i tillë njeh për viktimën. Në Shqipëri është krijuar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili synon të ndihmojë dhe të mbështesë viktimat apo ankimesit në rastet e diskriminimit, përfshirë ato gjinore. Komisioneri u shërben të gjithë shtetasve shqiptarë, pavarësisht profesionit të tyre, duke u vënë në dispozicion edhe të gazetareve femra që pretendojnë se janë diskriminuar për shkak të gjinisë. Komisioneri ka ngritur edhe një linjë telefonike, ndonëse nuk ka informacion për përdorimin e kësaj linje. Komisioneri është krijuar në zbatim të Ligjit 10221/2010.

Është krijuar praktika e rregullt e dënimit publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

Pikët (2.73) –Praktika e dënimit të qartë dhe pa ekuivok i sulmeve ndaj gazetarëve nuk është krijuar ende. Përkundrazi, vetë zyrtarët e qeverisë i sulmojnë verbalisht gazetarët. Edhe në rastet kur ka një dënim publik, ai bëhet në kontekstin e konfrontimeve politike.

Në vitin 2020, Kryeministri dhe politikanë të tjerë të nivelit të lartë të partisë në pushtet kanë vazhduar me sulmet e tyre verbale ndaj gazetarëve. Kryeministri u referohet gazetarëve dhe mediave si "kazan" dhe gjatë shpërthimit të pandemisë, ai paralajmëroi qytetarët që të mbroheshin nga virusi dhe media. Politikanët dënojnë sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve zakonisht sipas linjave të konfliktit partiak dhe politik. Opozita dhe Presidenti i Republikës kanë dënuar vazhdimisht kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve, por kryesisht si formë kritike dhe sulmi ndaj qeverisë. Gazetarët investigativë dhe mediat kritike nuk mendojnë se punojnë në një atmosferë të sigurt. Kërcënime të ndryshme që ata marrin bëhen pengesë për ushtrimin lirisht të profesionit të tyre. Partia në pushtet kontrollon shumicën e mediave audiovizive dhe për këtë arsye kërcënimet, frikësimi dhe presionet po kthehen në diçka normale.

Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve

Pikët (2.98) – Oficerët e policisë nuk treguan ndjeshmëri në veprimet e tyre gjatë vitit 2020 për gazetarët, disa raste u raportuan për ndalime të pabazuara të gazetarëve, veçanërisht gjatë mbulimit të protestave ose ngjarjeve të drejtpërdrejta. Autoritet policore kanë njohuri bazë se si të sillen me gazetarët dhe profesionistët e mediave, por nuk ka protokolle apo udhëzime për mbrojtjen e gazetarëve në praktikën e tyre të përditshme të punës. Ekzistojnë gjithashtu burime dhe kapacitete të kufizuara për të trajtuar një çështje të tillë të ndjeshme.

Punonjësit e policisë janë trajnuar përgjithësisht për standardet bazë të të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe për rolin e gazetarëve në një shoqëri demokratike si pjesë e arsimimit të tyre të përgjithshëm. Megjithatë, ndërgjegjësimi në këtë drejtim është krejtësisht bazik. Disa institucione shtetërore janë trajnuar se si të ndërveprojnë me gazetarët dhe profesionistët e medias, ndërkohë që protokollet zyrtare që janë miratuar kanë mangësi të theksuara. Me mbështetjen e donatorëve të huaj, janë organizuar trajnime, por ka ende nevojë për ngritje kapacitetesh dhe rritje të ndërgjegjësimit të këtyre institucioneve. Autoritetet e Policisë janë indiferente ndaj shoqatave të gazetarëve dhe nuk shprehin pozitivitet për bashkëpunimin me to. Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për trajtimin e gazetarëve në terren, oficerët e policisë nuk tregojnë ndjeshmëri ndaj gazetarëve në veprimet e tyre dhe i përlligjin këto veprime me pretekstin se nuk janë në gjendje t'i dallojnë gazetarët që nuk tregojnë distinktivin.

Në vitin 2020, janë regjistruar 7 raste të ndalimit pa bazë të gazetarëve nga policia teksa gazetarët raportnin duke ushtruar detyrën e tyre:

- Pas prishjes së Teatrit Kombëtar në 17 maj 2020, redaktori i portalit Politiko.al, Alfred Lela, u arrestua me dhunë teksa raportonte për protestën.
- Karikaturisti Diversanti i Exit New ishte në teatër gjatë kohës që po shkatërrohej ndërtesa dhe u nxorr me forcë e u arrestua nga forcat speciale, të cilat mësynë ndërtesën.
- Në 17 qershor Hila po filmonte prishjen e një ndërtese nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në një plazh në Lezhë duke përdorur celularin e tij.

- Në 30 tetor 2020, pak pas mesnatës, një shpërthim i fuqishëm tronditi shtëpinë e Eldion Ndreka, reporterit dhe gazetarit lokal të News24. Në momentin e shpërthimit, Ndreka ishte në shtëpi me familjen e tij. Shpërthimi shkaktoi vetëm dëme materiale.
- Më 11 dhjetor, policia ndaloi Xhoi Malësinë, gazetar dhe spiker i lajmeve në RTV Ora News, teksa filmonte protestat.
- Më 11 dhjetor, Qamil Xhani, kryeredaktor i Gazetës 'Koha Jonë', u arrestua teksa ishte në krye të detyrës.
- Redaktori i Durrës Lajm Shefqet Duka u ndalua nga policia teksa po largohej nga ambientet e medias pranë Sheshit Liria ku po zhvilloheshin protestat.
- Aldo Mustafa, gazetari lokal i Syri.net TV në qytetin e Durrësit ishte në detyrë duke raportuar drejtpërsëdrejti protestën në vendlindjen e tij kur u sulmua nga një prej policëve dhe nuk u lejua të filmonte dhe raportonte për ndalimin e protestuesve nga Policia.



Proces i rregullt

2.60



Njësitë dhe/ose oficerët e investigimit të specializuara janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

Pikët (2.96) – Agjencitë e zbatimit të ligjit janë të pajisura në mënyrë të moderuar me njohuritë dhe burimet për të hetuar sulmet dhe dhunën kundër gazetarëve. Mungojnë protokollet specifike të hetimeve për të siguruar zbulimin dhe ndjekjen efikase të agresionit dhe dhunës ndaj gazetarëve. Sfidat e përgjithshme që lidhen me reformën e vazhdueshme të drejtësisë dhe procesin e vetingut ndikojnë në kapacitetet dhe burimet e prokurorive dhe gjykatave për t'u marrë me rastet e gazetarëve.

Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë mangësi njohurish dhe burimesh për të hetuar sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve. Disa institucione shtetërore janë trajnuar se si t'i trajtojnë gazetarët dhe profesionistët e medias, ndonëse protokolle zyrtare që kanë miratuar janë të kufizuara. Kohët e fundit është hartuar një kurs i ri online në gjuhën shqipe për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gazetarëve që është organizuar për juristët, por edhe për gazetarët dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit në lidhje me identifikimin dhe trajtimin e kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias.

Në përgjithësi, policia dhe prokurorët i kanë kuptuar drejt veprat penale që lidhen me dhunën dhe sulmet ndaj gazetarëve. Gjithsesi, nuk janë hartuar apo institucionalizuar udhëzime për të siguruar zbulimin dhe ndjekjen penale të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve. Këto raste trajtohen brenda praktikave të zakonshme të hetimit. Duke pasur parasysh sulmet që u janë bërë gazetarëve në tre vitet e fundit, asnjë çështje nuk është zgjidhur.

Në shtator 2020, Prokuroria e Përgjithshme nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme për më shumë efikasitet në hetimin e çështjeve sipas nenit 59 të Kodit Penal. Në këtë memorandum gazetarët nuk trajtohen veçmas.

Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë efikase (të pavarur, të plotë dhe të menjëhershme)

Pikët (2.61) – Sulmet fizike kundër gazetarëve gjatë viteve të fundit nuk janë hetuar siç duhet. Disa raste mbeten të pazgjidhura dhe ka transparencë të kufizuar në procesin hetimor edhe për shkak të fshehtësisë së hetimit. Zakonisht këto procese janë të gjata, të ngadalta dhe me informacion të kufizuar publik.

Sulmet fizike ndaj gazetarëve gjatë viteve të fundit nuk janë hetuar siç duhet. Raste të ndryshme të sulmeve fizike dhe kërcënimeve serioze ndaj gazetarëve në lidhje me raportimin e tyre mbeten të pazgjidhura nga autoritetet, përfshirë këtu edhe sulmin me armë zjarri kundër shtëpisë së babait të gazetares së kronikës në Shqipëri, Klodiana Lala, në 2018, sulmin në 2017 ndaj gazetarit Elvi Fundo, i cili raportohet se është larguar nga vendi dhe ka kërkuar azil në Gjermani, ose shpërthimin e një pajisjeje eksplozivi në shtëpinë e gazetarit, Elion Ndreka në vitin 2020. Për sa i përket pritshmërive të këtij treguesi, është e rëndësishme të kihet parasysh se marrja e informacionit për një hetim, në parim, është e vështirë, sepse hetimet orientohen nga parimi i fshehtësisë dhe natyra e informacionit të kërkuar nga ky tregues është pjesë e dosjes së hetimit që është private dhe mund të aksesohet vetëm nga prokuroria dhe policia. Edhe pse informacioni për çështjet e mbyllura është më i lehtë për t'u marrë, tendenca e prokurorisë është t'i mbajë këto dosje larg syrit të publikut.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme të ngacmimeve online

Pikët (2.58) – Autoritetet shtetërore nuk kanë njohuri, kompetenca, burime dhe procedura për mbrojtjen e gazetarëve nga ngacmimet online. Nuk janë marrë masa specifike për të mbrojtur gazetarët nga sulmet online. Ngacmimi online është veçanërisht shqetësues për gazetaret femra.

Ka pasur disa raste që janë raportuar për kërcënimet online. Një rast i njohur në vitin 2020 ishte ai i gazetares televizive, Sonila Meço, e cila u bë pre e një sërë abuzimesh online, pas akuzave nga mediat për mosrespektimin e mjekëve në vend në një postim që ajo bëri në mediat sociale. Një rast tjetër ishte ai i gazetares britanike Alice Tayler, e cila fitoi një proces gjyqësor shpifjeje kundër disa organeve mediatike pro-qeveritare, pasi u etiketua si spiune ruse për një intervistë që ajo dha për Russia Today. Mbrojtja kundër kërcënimeve sanksionohet posaçërisht në Kodin Penal, që e konsideron ngacmimin si vepër penale por nuk njeh ngacmimin online si të tillë. Gjithsesi, kjo nuk përbën pengesë që ngacmimi online të mos gjykohet edhe në bazë të kësaj dispozite të përgjithshme, pasi objekti si vepër penale mbetet i njëjtë dhe është i vlefshëm për gjykatën pavarësisht nga mënyra si është bërë ky ngacmim. Nuk janë marrë masa specifike për mbrojtjen e gazetarëve nga sulmet online.

Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente

Pikët (2.57) – Nuk ka tregues që të evidentojë se kryhen hetimet për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Autoritetet nuk japin të dhëna të përditësuara për rastet kryesore të sulmeve fizike ndaj gazetarëve.

Nuk ka asnjë tregues që të evidentojë se kryhen hetimet për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Autoritetet nuk japin të dhëna të përditësuara për rastet kryesore të sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Institucionet e drejtësisë normalisht duhet të kenë rregulla për marrëdhëniet/komunikimin me publikun, por jo gjithnjë ndodh kështu. Megjithatë, në vitin 2019, Prokuroria e Përgjithshme nxori një Udhëzim për Marrëdhëniet me Publikun në Prokuroritë e Juridiksionit, udhëzim që rregullon paksa edhe rolin e policisë gjyqësore në dhënien ose refuzimin e nxjerrjes së informacionit që marrin gjatë një hetimi. Në përgjithësi, marrëdhëniet e institucioneve të drejtësisë me mediat rregullohen me dispozita të përgjithshme në ligjin organik të secilit institucion të drejtësisë. Viktima ka akses në informacionin përkatës (për sa kohë që nuk e pengon fshehtësinë e hetimit). Për më tepër, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë edhe Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 5, datë 26.10.2018, "Për garantimin e ndihmës viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale". Ky udhëzim përshkruan në thelb mënyrën se si prokurorët dhe policia gjyqësore duhet të trajtojnë viktimat, të drejtat që u ofrohen atyre, përfshirë edhe mbrojtjen fizike nëse është e nevojshme. Konventa e Stambollit përmendet si një nga bazat ligjore për nxjerrjen e vendimit të përmendur. Gjithsesi, është e vështirë të evidentohet sa është zbatuar ky udhëzim.

Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë

Pikët (2.28) – Asnjë nga autoritetet kompetente shtetërore dhe gjyqësore nuk kanë krijuar sisteme cilësore dhe specifike të mbledhjes së statistikave mbi sulmet kundër gazetarëve dhe mbi pandëshkueshmërinë. Institutions Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla.

Nuk ka asnjë tregues që të evidentojë se kryhen hetimet për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Autoritetet nuk japin të dhëna të përditësuara për rastet kryesore të sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Institucionet e ndryshme të drejtësisë, si gjykatat, prokuroria dhe organet e zbatimit të ligjit si policia, mbajnë statistikën në sistemet e tyre, shpesh duke e cilësuar dhe përpunuar informacionin ndryshe nga institucionet e tjera dhe kjo e bën të vështirë marrjen e shifrave të unifikuara/ të konsoliduara dhe plotësisht përfaqësues në vjetarin statistikor të Ministrisë së Drejtësisë. Institucionet në Shqipëri nuk publikojnë të dhëna në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve dhe pandëshkueshmërinë. Këto institucione nuk kanë të dhëna të hollësishme për sulmet ndaj gazetarëve. Nga ana tjetër, atyre u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla. Këshilli i Evropës, Reagimi i Shpejtë i Lirisë së Medias dhe Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt janë mekanizmat kryesorë për monitorimin dhe raportimin e rregullt për kërcënimet ndaj gazetarëve.

IV

Siguria aktuale

2.78



1.00
2.00
3.00
4.00
5.00
6.00
7.00

Ka raste të rënda të kërcënimeve dhe sulmeve aktuale kundër gazetarëve dhe organizatave të medias, përfshirë vrasjet.

Nuk ka pasur raste të sulmeve aktuale, asnjë kërcënim kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve, as nuk ka pasur kërcënime dhe ngacmime jo fizike kundër gazetarëve dhe mediave.

Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike

Ky dimension i referohet aspekteve reale të sigurisë së gazetarëve, d.m.th. kërcënimeve, ngacmimeve dhe sulmeve fizike që ndodhën faktikisht gjatë vitit në fjalë.

Pikët (3.60) – Disa raste janë identifikuar si kërcënuese për punën e pavarur të gazetarëve në Shqipëri nëpërmjet shtimit të padive kundër gazetarëve, veçanërisht gazetarëve investigativ. Këto padi zakonisht ngrihen nga zyrtarë qeveritarë, politikanë dhe korporata të mëdha biznesi.

Janë identifikuar disa raste si kërcënim për punën e pavarur të gazetarëve në Shqipëri përmes ngritjes së proceseve gjyqësore kundër gazetarëve, veçanërisht gazetarëve investigativë. Paditë SLAPP (Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike) po bëhen të shpeshta në mediat shqiptare si mekanizëm për të censuruar, kërcënuar apo për të bërë të heshtin media të pavarura, gazetarë investigativë dhe kritikë duke iu ngarkuar atyre koston e mbrojtjes ligjore derisa të detyrohen të braktisin investigimet apo kritikën. Në janar Acromax kërcënoi se do të padiste Alice Taylor dhe Exit.al për një investigim që kishin bërë për punën e kësaj kompanie për Partinë Socialiste në Shqipëri, përfshirë këtu heqjen e përmbytjes kritike nga platformat sociale si Facebook dhe YouTube. Padia nuk u materializua kurrë. Më vonë po atë vit, investigimi u vazhdua nga portali gjerman Netzpolitik, i cili tha se Acromax ka "efekt ftohës në lirinë e mediave në Shqipëri." Çështja e dytë i referohet padisë SLAPP në dhjetor 2020 në Shqipëri kundër gazetarit investigativ Artan Rama, i cili publikoi në 6 nëntor 2020 një artikull investigativ "Prapaskenat e një kontrate të Dytë për Inceneratorin e Elbasanit". Pas këtij artikulli, Albtek Energy, e cila fitoi koncesionin për ndërtimin e inceneratorit të mbetjeve në Elbasan gjashtë vjet më parë, paditi gazetarin investigativ për shpifje. Artan Rama tha se i qëndronte artikullit të botuar dhe se do ta mbronte atë në gjykatë. Çështja e tretë është një tjetër padi gjyqësore. Shefja e Kabinetit të Ministrisë së Mbrojtjes kishte paditur gazetaren Juli Ristani, e cila kishte botuar në gazetën 'Shqip' një artikull investigative për akordimin e bursave për studime mjekësore ushtarake në Greqi, të ofruara nga NATO.

Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

ëtu mund të përfshihen: Kërkesa për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; Kërkesa për dëmtime fizike kundër gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; Këto kërcënime mund të: Bëhen drejtpërdrejt ose nëpërmjet palëve të treta; Dërgohen me komunikim elektronik ose ballë për ballë; Jenë të drejtpërdrejta ose të nënkuptuara.

Pikët (4.26) – Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve ekzistojnë në mënyrë të nënkuptuar dhe të qartë dhe disa raste u raportuan në vitin 2020 nga Rrjeti i Sigurt i Gazetarëve dhe platforma të tjera ndërkombëtare për lirinë e medias. Sidoqoftë, raste të tilla nuk janë sistemike.

Në 24 mars 2020, Gazetari i Ora News Elio Laze publikoi një video ku kërcënohej nga një punonjës i Firmës së Ndërtimit Salillari. Gazetari ndodhej në kantier në rrugën e Unazës në Tiranë dhe po filmonte kompaninë që po vazhdonte punimet, edhe pse aktivitete të tilla ishin të ndaluara për shkak të kufizimeve të Covid-19. Si rezultat i kësaj shkeljeje, gazetari filmoi punëtorët teksa punonin dhe iu afrua njërit prej tyre për komente. Punonjësi i Salillarit, një prej kompanive të preferuara të ndërtimit të qeverisë, u përgjigj duke u treguar agresiv verbalisht dhe fizikisht me gazetarin dhe duke e kërcënuar atë.

Sulme aktuale

Këtu mund të përfshihen: dëmtimet fizike ose mendore, rrëmbimet, dhunimi i shtëpisë/zyrave, sekuestrimi i pajisjeve, ndalimi arbitrar, tentativa të dështuara për vrasje, etj.

Pikët (3.43) – Sulmet aktuale kundër gazetarëve janë regjistruar në vitin 2020 siç janë dëmtimet fizike aktuale, ndalimi arbitrar, konfiskimi i pajisjeve dhe ndërprerja e raportimit veçanërisht gjatë protestave në maj dhe dhjetor 2020.

Pas shembjes së Teatrit Kombëtar në 17 maj 2020, redaktori i Politico.al Alfred Lela u arrestua me dhunë teksa raportonte për protestën. Policia pretendoi se ai “nuk ishte në detyrë” në atë kohë. Ai u la i lirë pa iu ngritur ndonjë akuzë, por pretendoi se ishte sulmuar dhe ofenduar verbalisht nga policia. Karikaturisti Diversanti i Exit New ishte në teatër gjatë kohës që po shkatërrohej ndërtesa dhe u nxor me forcë e u arrestua nga forcat speciale të cilët mësynë ndërtesën. Ai u la i lirë pa iu ngritur ndonjë akuzë, por raportoi përdorimin e dhunës dhe forcës së tepruar nga policët që mbanin armë gjysmë-automatike. Në 17 qershor Hila po filmonte prishjen e një ndërtese nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në një plazh në Lezhë duke përdorur celularin e tij. Pasi Hila u tha se ishte gazetar, oficeri i policisë i mori telefonin nga duart, duke bërë titur “Çfarë gazetari je?!?”. Ai u ndalua edhe pse e identifikoi veten si gazetar disa herë dhe oficerët e policisë në zonë kishin informuar shefin e policisë për profesionin e tij. Ai u ndalua në automjetin e policisë pranë vendit të rrënojave të prishjes së ndërtesës dhe më pas u la i lirë për shkak të presionit nga gazetarët e tjerë. Në 30 tetor 2020, pak pas mesnatës, një shpërthim tronditi shtëpinë e Eldion Ndreka, reporterit dhe gazetarit lokal të News24. Në momentin e shpërthimit, Ndreka ishte në shtëpi me familjen e tij. Shpërthimi shkaktoi vetëm dëme materiale. Pamjet e kamerave të sigurisë tregojnë një person duke dalë nga një makinë, duke lënë eksplozivin dhe duke u larguar me shpejtësi nga vendi. Policia dhe prokurorët erdhën menjëherë në vendngjarje në qytetin e Lezhës dhe po vazhdojnë me hetimet për rrethanat e ngjarjes, për identifikimin dhe kapjen e autorit të kësaj vepre. Asnjë arrestim nuk është bërë deri tani për këtë ngjarje. Më 11 dhjetor, policia ndaloi Xhoi Malësinë, gazetar dhe spiker i lajmeve në RTV Ora News, teksa filmonte protestat. Gazetari u lirua pas tre orësh, por raportoi abuzime me të drejtat e tij: “Më ndaloi policia teksa po filmoja protestën, edhe pse u identifikova si gazetar. Më morën në rajonin e policisë, ku oficerët e policisë më keqtrajtuuan dhe më fyen,” tha Malësia për Rrjetin e Gazetarëve të Sigurt. Ai shtoi se nuk e kishin lejuar

të ushtronte të drejtën e një telefonate. “Më liruan tre orë më vonë pasi më detyruan të firmosja një deklaratë që nuk e kisha shkruar, por që mu imponua nga oficerët e policisë si kusht për të më lënë të lirë.” Më 11 dhjetor, Qamil Xhani, kryeredaktor i gazetës së përditshme ‘Koha Jonë’, u arrestua teksa ishte në krye të detyrës. Pasi kishte mbaruar raportimin, Xhani u bë dëshmitar i dhunës që policia po ushtronte ndaj protestuesve. Ai u kërkoi punonjësve të policisë të ndalonin përdorimin e dhunës, por u prangos dhe u ndalua bashkë me 50 protestues të tjerë. Xhani deklaroi se ishte goditur në kokë dhe në shpinë. Policia i sekuestroi celularin dhe i fshiu të gjitha pamjet dhe filmimet. Edhe atij iu bë presion për të nënshkruar një deklaratë duke pranuar se ishte ndaluar për “pjesëmarrje në një tubim të paligjshëm”. Xhani u la i lirë vetëm kur botuesi i “Koha Jonë” kontaktoi drejtpërdrejtë me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe çështja u raportua live në mbrëmjen e programit televiziv. Redaktori i Durrës Lajm Shefqet Duka u ndalua nga policia teksa po largohej nga ambientet e medias pranë Sheshit Liria ku po zhvilloheshin protestat. Ai u dërgua në rajonin e policisë dhe ishte mbajtur për më shumë se tre orë. Stafi i Durrës Lajm kontaktoi zëdhënësin e policisë vendore për të shprehur shqetësimet e tyre. Pas lirit, Duka konfirmoi se oficerët e policisë nuk kishin përdorur dhunë ndaj tij, por kishte qenë dëshmitar i dhunës ndaj protestuesve të tjerë. Aldo Mustafa, gazetari lokal i Syri.net TV në qytetin e Durrësit, ishte në detyrë duke raportuar drejtpërdrejt protestën në vendlindjen e tij kur u sulmua nga një prej policëve dhe nuk u lejua të filmonte dhe raportonte për ndalimin e protestuesve nga Policia.

Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve

Në këto kërcënime bëjnë pjesë: Ngacmimi me thirrje telefonike; Ngacmimi arbitrar gjyqësor ose administrativ; Forma të tjera presioni (shkrime në mur, postime kërcënuese etj.). Sulme aktuale: Dhunim zyre, Konfiskim pajisjesh, thyerje pajisjesh, dëmtim pajisjesh, automjetesh, etj.

Pikët (3.84) – Në vitin 2020, ka pasur vetëm disa raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj mediave dhe asnjë rast sulmi ndaj shoqatës së gazetarëve.

Në janar, Acromax kërcënoi të padiste Alice Taylor dhe Exit.al për një hetim që këta të fundit kishin bërë për punën e kompanisë. Taylor kishte publikuar një artikull ku përfshinte detaje të një bisede që kishte zhvilluar me pronarin e Acromax, Aldor Nini. Në atë bisedë, Nini pranote se Partia Socialiste ishte klient i kompanisë së tij dhe madje dërgoi shembuj të punës që kishte bërë për ta. Kjo përfshinte heqjen e përmbajtjes nga platformat e mediave sociale, të tilla si Facebook dhe YouTube. Nini më vonë pretendoi se PS nuk ishte më klienti i kompanisë së tij dhe kërcënoi me padi gjyqësore në Gjermani dhe Shqipëri kundër Taylor dhe portalit Exit.al. Padia nuk u materializua asnjëherë. Faqja e internetit e Citizen Channel u sulmua disa herë dhe më pas u bllokua plotësisht për shkak të sulmeve kibernetike.

Titulli origjinal
Treguesi i Nivelit të Sigurisë së Gazetarëve në
Ballkanin Perëndimor
Raport përshkrues Shqipëria 2021

Publikuesi
Independent Journalists Association of Serbia



Autor
Blerjana Bino

Eksperti ligjor
Blerina Fani

Eksperti i Medias
Aleksandër Çipa

Përkthyes
Durim Tabaku

Dizajn
comma.rs

Ky publikim është prodhuar me asistencën e Bashkimit Evropian dhe Mbrojtësve të Drejtave Civile. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së Pavarur të Gazetarëve të Serbisë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Mbrojtësve të Drejtave Civile.

